

**V E N D I M**  
**Nr.142, datë 5.4.1994**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.511, DATË  
26.10.1993 “PËR NDRYSHIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES BRENDË VENDIT TË DISA  
LËNDËVE TË PARA, MATERIALEVE, PJESËVE TË NDËRRIMIT, MAKINERIVE ETJ.,  
TË ARDHURA NË KUADRIN E NDIHMAVE DHE KREDIVE ME KUSHTE  
FAVORIZUESE NGA INSTITUCIONE NDËRKOMBËTARE E SHTETE TË VEÇANTA, SI  
DHE PËR MËNYRËN E PAGESËS SË TYRE”**

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë dhe të Tregtisë, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.511, datë 26.10.1993, në pikën 1 të kreut I shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Në këtë mënyrë të formohen edhe çmimet e mallrave të importuara me kredinë kineze të vitit 1991, të cilat për shkak të eksodit u shkarkuan në portet e Pireut dhe të Rjekës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**